

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shtëpi me 60 mijë euro në Tiranë? Ministrja: Ka në periferi, do të jepen 4 mijë kredi të buta, jo për qëllim e elektorale
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/politike/shtepi-me-60-mije-euro-ne-tirane-ministrja-ka-ne-p eriferi-do-i1184844
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 09:13:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 08:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a313daccdd33e69f3d9b5494376bf77bb4f2b4cba9deb516569af44c3447c4d34
TEKSTI	65b0388a6ca4814e78909e6155de6200f028a24f15ab0a364d04ac1e450d30a4
PAMJA	88690dd44ccdf66e1b8ee8d892bd2ab78ace4b641d1ad52eafc3077de3f8d6ba

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8baf2baf3ba0d28570fd9e39dbaa5c5d6e1bb37f7b6f3c449154a459f0e1b1ea
E MËPARSHMJA	d3437d31c361ec32cc1ec098f3d2e376732bd452c1818e1a429c1e75cb50c832
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8baf2baf3ba0d28570fd9e39dbaa5c5d6e1bb37f7b6f3c449154a459f0e1b1ea>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px




- [Shqipëria](#)
- [Kosova](#)
- [Rajoni & Bota](#)
- [Argëtim](#)
- [Sport](#)
- [Turizëm](#)
- [Blog](#)
- [Speciale A2](#)
- [Moti](#)
- [Emisionet](#)



Shtëpi me 60 mijë euro në Tiranë? Ministrja: Ka në periferi, do të jepen 4 mijë kredi të buta, jo për qëllime elektorale

Nga A2 CNN
11 Shtator 2026, 10:41 | [Politikë](#)



Qeveria ka njoftuar një reformë të re për strehimin kryesisht të të rinjve dhe profesionistëve. Pas mbledhjes së qeverisë, ministrja e Ekonomisë Delina Ibrahimaj bëri të ditur se do të jenë 7 mijë apartamente në dispozicion, do të jepen 4 mijë kredi të buta nga të cilat gjysma me zero interes për apartamente me vlerë 60 mijë euro. Sipas saj këto do të mbulohen nga Fondi Kombëtar i Strehimit.

“Reformë e re jo vetëm për shtresat në nevojë për profesionistë të e rinj. 7 mijë apartamente në dispozicion, ku do të jenë 4 mijë kredi të buta 2 mijë me zero interes për apartamente deri në 60 mijë euro vlerë ku do u jepen profesionistëve të rinj dhe çiftëve të reja. Për apartamentet e mëdha do të jenë në dispozicion 3 mijë apartamente me normë interesi fikse 3 %. Do mbulohen nga Fondi Kombëtar për Strehimin, Është fondi që mbliidhet nga bashkitë, buxheti i shtetit për strehimin dhe mekanizma të tjerë të kredive si BEI e cila ka një program specifik për strehimin. Do vëmë subvencion qiraje për 3 mijë apartamente që i dedikohen jo vetëm shtresave në nevojë, por edhe familjeve të reja e profesionistëve që sa kanë mbaruar shkollën vendosin të kthehen në vendbanimin e tyre dhe ne do t'i mbështesim, t'i garantojmë një fillim jetese më të sigurt, se strehimi është kryesor për qytetarët. Kemi më shumë se 80% të shqiptarëve që jetojnë në pronësinë e tyre. Do fillojmë ndërtimin e disa blloqeve të ndërtesave”, tha Ibrahimaj.

E pyetur nga gazetarja e A2 CNN, Fjorela Beleshi nëse kjo paketë e strehimit bëhet për qëllime elektorale, ajo u përgjigj:

“S’do të hyjë në fuqi në 2027. Paketa ligjore miratohet në fillim të tetorit. Thirrjet do të hapen po gjatë vitit aktual. Duke qenë se ka proces administrativ për menaxhimin e thirrjeve, fituesit do t’i shpallim në fillim të vitit 2027. Në programin e PS-së kemi pasur fokus te strehimi. Strehimi është një çështje që meriton më shumë fokus, zgjerimi i kësaj politike meriton vëmendje të veçantë. Ky nuk është program elektorale, zgjedhje ka çdo dy vjet. Çdo politikë që ne bëjmë, s’duhet ta lidhim domosdoshmërisht me programet elektorale”, tha Ibrahimaj.

E pyetur gjithashtu se në cilën zonë të Tiranës ka një banesë me vlerë 60 mijë euro, ministrja tha se ka në periferi të kreyqytetit.

“Ka në periferi të Tiranës, janë apartamente të sipërfaqeve të vogla, nuk i dedikohen familjeve të mëdha. Ndaj thashë ky program i dedikohet profesionistëve që sapo kanë mbaruar studimet dhe duan të jetojnë pranë vendit të punës. Është një proces që ndodh në të gjitha vendet e botës”. (A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU

[Klodiana Spahiu betohet në Presidencë, merr detyrën si ministre shëndetësie](#)

10:39

[“Besforti do të kalojë në stolin tim në Kryeministri”, Rama bën ndryshime në qeveri: Ervin Demo do të mbulojë Punët e Brendshme](#)

10:26

[Shkarkohet ministri i Brendshëm, Besfort Lamallari. Ervin Demo ministër i Brendshëm](#)

10:11

[Begaj përkujton 25-vjetorin e sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001: Ideologjitë urrejtëse sjellin pasoja të tmerrshme](#)

08:47

[“Protestuesit dolën sorra, siç tha Rama”, Basha debat me Çëpanin: U rrahën me njëri-tjetrin](#)

22:44

[“Po na tërhiqni zvarrë!”, Çëpani debat me Bylykbashin. Deputetja: Kolegun tim e ndoqën deri në shtëpi!](#)

21:58

TE FUNDIT

[Gjykata merr vendim për pagat, Administrativja pro kolegëve: Ministria t’i paguaj!](#)

16:40

[Votime, grindje dhe krizë pa fund, Kuvendi vijon të dielën, PDK heq dorë dhe pret Kushtetuesen](#)

16:35

[“Administrativja hapi dyert e thesarit për të rritur rrogat e veta!”, reagon Rama: Sikur të kishte të njëjtin standard për hallet e qytetarëve](#)

16:20

[Klodiana Spahiu merr detyrën si ministre e Shëndetësisë: Sfida e parë është për besimin](#)

16:16

MË TË VIZITUARAT

[Rusia sulmon sërish Kievin: Dy të vrrarë dhe disa të plagosur](#)

16:09

[Makina e re e Kryeministrit, ministrja e Shtetit: Është marrë me qira, e pagu...](#)

15:36

[“Reforma, shkak që kalova ylberin”, Dash Sula: Asnjë inspektim pa kamera, njo...](#)

15:13

Live Updates

[Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë](#)

07:28

[LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore](#)

09:08

[Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri](#)

10:52

Latest Videos

 Rrogat miliona lekë të gjyqtarëve, Avokati: Edi Rama do ti përplasën me qytetarët

[Rrogat miliona lekë të gjyqtarëve, Avokati: Edi Rama do ti përplasën me qytetarët](#)

 Jemi në një fazë të rrezikshme, Rama po përpigjet ta mbajë pushtetin me çdo kusht

[“Jemi në një fazë të rrezikshme, Rama po përpigjet ta mbajë pushtetin me çdo kusht”](#)

 Mbi 100 ditë protestë, pedagogu: Do të ketë një protestë të madhe ditën e...

Mbi 100 ditë protestë, pedagogu: Do të ketë një protestë të madhe ditën e...

 [A e mbylli Berisha kapitullin e “nongratës”? Pedagogu: U penduan amerikanët? Pse s`ka një dokument...](#)

A e mbylli Berisha kapitullin e “nongratës”? Pedagogu: U penduan amerikanët? Pse s`ka një dokument...

- [Shqipëria](#)
 - [Aktualitet](#)
 - [Kronikë](#)
 - [Politikë](#)
 - [Ekonomi](#)
 - [Sociale](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Moti](#)
- [Kosova](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Sociale](#)
 - [Ekonomi](#)
 - [Politikë](#)
 - [Kronikë](#)
 - [Aktualitet](#)
- [Rajoni & Bota](#)
 - [Ballkani](#)
 - [Bota](#)
- [Argëtim](#)
 - [Showbiz](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Kapur në kamera](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Live Euro 2024](#)
 - [Futboll](#)
 - [Sporte të tjera](#)
- [Speciale A2](#)
 - [5 gjëra në 5 minuta](#)
 - [A2 CNN në Izrael](#)
 - [31 Minuta](#)
 - [A2 CNN në Ukrainë](#)
 - [Lumi i kokainës](#)
 - [Ditari ndërkombëtar](#)
 - [Zbulo](#)
 - [Imagjinatë](#)
 - [Dëshmi](#)
- [Shqipëria](#)
- [Rajoni & Bota](#)
- [Argëtim & Teknologji](#)
- [Sport](#)
- [Fotolajme](#)
- [Moti](#)
- [Live Updates](#)
- [Speciale A2](#)
- [Emisionet](#)



 [A2 CNN LOGO](#)
[Live TV](#)



[Rreth nesh](#) [Kushtet e Privatësisë](#) [Karriera](#) [Kontakt](#)

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.